


# Ngritja e efijencës së energjisë në Kosovë





Federal Ministry  
for Economic Cooperation  
and Development

balkangreenfoundation

# Ngritja e efiçencës së energjisë në Kosovë

Ky punim është hartuar në kuadër të projektit: "Tranzicioni i energjisë dhe dekarbonizimi në Ballkanin Perëndimor," i cili mbështetet nga Ministria Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ) dhe zbatohet nga Balkan Green Foundation në bashkëpunim me Germanwatch, Belgrade Open School dhe Ekosvest.



Balkan Green Foundation (BGF) është një organizatë rajonale që promovon përparim gjithëpërfshirës dhe të barabartë brenda Ballkanit Perëndimor në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm.

## Contents

- Përmbledhje ekzekutive—**3**
- 1. Hyrje dhe metodologjia—**4**
- 2. Korniza politike, ligjore dhe strategjike—**7**
- 3. Analiza e gjendjes - efiçenca e energjisë në Kosovë—**11**
- 4. Masat, politikat dhe veprimet e qeverisë—**14**
- 5. Targetet e efiçencës së energjisë—**16**
- 6. Rekomandime—**18**
- 7. Përfundim—**23**
- 8. Referencat—**24**



# Përmbledhje ekzekutive

Ky raport ofron një përshkrim të përgjithshëm të gjendjes dhe situatës rreth eficiencës së energjisë në Kosovë, duke theksuar veçanërisht iniciativat e qeverisë në këtë fushë. Raporti gjithashtu shqyrton perspektivat dhe sfidat në përafrimin me objektivat e Komunitetit të Energjisë dhe Bashkimit Evropian për vitet 2030 dhe 2050. Situata aktuale e eficiencës së energjisë në Kosovë, thekson nevojën për ndërhyrje strategjike për të rritur qëndrueshmërinë e përgjithshme dhe për të reduktuar ndikimin negativ ekonomik dhe mjedisor që rrjedhë nga mungesa e eficiencës në këtë sektor.

Sektorët e energjisë dhe klimës janë shumë të ndërlidhur, rrjedhimisht kjo nënkupton një urgjencë të madhe drejt ngritjes së eficiencës së energjisë dhe fuqizimit të energjisë së ripërtëritshme për të ulur emetimet e gazrave serrë, për të mbrojtur përgjithësisht ekonominë dhe shëndetin publik, duke ulur gjithashtu ndotjen e ajrit. Kjo do të ndikonte sadopak edhe në parandalimin e fatkeqësive në të ardhmen të ndërlidhura me ndryshimet klimatike, si përmbytjet e mëdha, thatësitat dhe komplikimet e shumta ekonomike dhe shëndetësore që rrjedhin prej tyre. Kjo analizë vë në pah modele joefikase të konsumit të energjisë në sektorë të ndryshëm, veçanërisht në sektorin rezidencial, duke ofruar rekomandime për ndërhyrje të targetuara për të optimizuar përdorimin e energjisë dhe për t'i minimizuar humbjet. Këto praktikisht mund të gjinden tek pjesa e rekomandimeve në këtë punim.

Gjatë përgatitjes së këtij raporti, janë konsultuar institucionet kyçe, janë mbledhur informacione dhe rekomandime nga: Zyra e Rregullatorit për Energji – ZRRE, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, Shoqata e Energjisë së Ripërtëritshme të Kosovës, sektori privat, bizneset dhe qytetarët. Është e rëndësishme të theksohet se të gjitha palët e interesit shohin përgjithësisht përfitim të madh nga zbatimi i masave të eficiencës së energjisë, duke e parë atë

si diçka thelbësore për të arritur qëndrueshmëri ekonomike dhe mjedisore, por edhe si diçka sfiduese për t'u arritur në një shkallë më të gjërë dhe më të shpejtë për shkak të natyrës intenzive financiare që kërkohet, prandaj qeveria duhet të kontribojë dhe ndërhyjë në këtë sektor.

Është inkurajues fakti se qeveria e mbështetur financiarisht dhe përmes asistencës teknike nga Bashkimi Evropian dhe donatorët tjerë po zhvillojnë shumë projekte në ngritjen e eficiencës së energjisë në Kosovë. Kjo është bërë praktikisht përmes ofrimit të subvencioneve dhe rimbursimeve në pajisje eficiente për sektorin privat dhe atë rezidencial, por edhe ka ndihmuar ndërhyrjet në sektorin publik. Në sektorin privat, subvencionimi dhe nxitja e familjeve për të aplikuar për pajisje të energjisë së ripërtëritshme, stufa eficiente dhe stimulimi i familjeve që kursejnë energji të kompensohen në faturën e energjisë elektrike. Një aspekt shumë i rëndësishëm pozitiv ishte ofrimi i subvencioneve deri në 50% për familjet në sektorin privat/rezidencial që kanë të drejtë të aplikojnë masa të eficiencës së energjisë në banesat/shtëpitë private, si termoizolimi i mureve, ndërrimi i dyerve dhe dritareve joeficiente, izolimi i çatisë etj., kanë pasur ndikime pozitive dhe praktike. Këto janë disa nga programet më të mëdha dhe shumë premtuese që kanë mundur avancimin e sektorit të eficiencës së energjisë në një nivel krejtësisht të ndryshëm deri më tani dhe u ofrojnë kompanive implementuese përvojë të rëndësishme në këtë sektor.

Masat e ndërmarra nga qeveria e Kosovës me mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare si BE-ja, mund të konsiderohen të suksesshme, për shkak të ndikimit pozitiv në uljen e kërkesës për energji. Fillimisht, përmes vendosjes së bllok tarifave, e më pas me subvencione për masat e eficiencës së energjisë, gjë që ka përmirësuar edhe ndotjen e ajrit në Kosovë dhe ka ulur konsumin e druve të zjarrit dhe si rezultat ka ulur edhe shpyllëzimin, pasi që kërkesa për këtë lëndë djegëse është ulur ndjeshëm.

# 1. Hyrje dhe metodologjia

Varësia e madhe e Kosovës në thëngjill për prodhimin e energjisë dhe ngrohjes, intensiteti i lartë energjetik, shpyllëzimi, ndotja e ajrit dhe humbjet e larta të energjisë elektrike prej rreth një të katërtës së energjisë elektrike që është në sistem, paraqesin sfida që kërkojnë vëmendje të menjëhershme nga politikëbërësit dhe vendimmarrësit përkatës.

Efiçienca e energjisë është një shtyllë e rëndësishme ekonomike, sistemike, shëndetësore dhe mjedisore për zhvillim të qëndrueshëm, mirëqenien sociale dhe një masë e rëndësishme për të reduktuar ndjeshëm lirin e gazrave serrë dhe për të frenuar pasojat negative të ndryshimeve klimatike dhe gjithashtu për të përmirësuar cilësinë e ajrit. Zbatimi i masave të efiçencës së energjisë kërkon ndryshimin e zakoneve të përditshme të qytetarëve dhe institucioneve drejt përdorimit të energjisë. Ajo gjithashtu kërkon shumë mjete financiare, stimuj dhe politika inovative për t'u zbatuar. Nuk është një proces i thjeshtë, është relativisht i gjatë në kohë dhe përballet me shumë pengesa ekonomike dhe strukturore, megjithatë investimet në këtë fushë janë afatgjata dhe japin rezultate ekonomike të prekshme dhe pozitive.

Kosova ka treguar një përparim, veçanërisht me prezantimin e Strategjisë ambicioze të Energjisë në mars 2023, fillimin e ankandit të parë diellor në maj 2023 dhe investimet e vazhdueshme në rritjen e efiçencës së energjisë në ndërtesat publike dhe rezidenciale, në përputhje me planin e veprimit të Paketës së Mbështetjes së Energjisë. Megjithatë, mbështetja e madhe e Kosovës në thëngjill në nivelin 92% për prodhimin e energjisë elektrike dhe 55% të energjisë totale (sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës - ASK), përveç se është një emetues kryesor i gazrave serrë, paraqet një rrezik të madh shëndetësor dhe mjedisor. Objektivat e përkrahura në Strategjinë e re të Energjisë dhe Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) duhet të korrespondojnë me përpjekjet e Kosovës për të rritur sigurinë e furnizimit me energji.<sup>1</sup>

Për më tepër, modernizimi i infrastrukturës, veçanërisht në rrjetin e shpërndarjes, modernizimi dhe investimet e përgjithshme në rrjetet inteligjente dhe përmirësimi i infrastrukturës së energjisë në përgjithësi për të përmirësuar efiçencën, për të reduktuar humbjet dhe për të integruar burimet e ripërtëritshme në rrjetin kombëtar, është një parakusht themelor që tranzicioni i energjisë të fillojë në Kosovë.

Vendi urgjentisht duhet të zgjerojë dhe të ndërmarrë masat e efiçencës së energjisë në përgjithësi, pasi këto në situatën aktuale nuk janë të mjaftueshme dhe janë në një nivel relativisht të ulët në krahasim me nevojat e vendit. Nga rreth 600,000 amvisëri të regjistruara në kompaninë e shpërndarjes së energjisë elektrike KEDS<sup>2</sup>, rreth 2,000 shtëpi janë përkrahur për intervenim nga Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë<sup>3</sup>, prandaj potenciali për ndërhyrje është shumë i lartë. Shkalla e lartë e burimeve të ripërtëritshme të energjisë si raporti aktual i burimeve të ripërtëritshme është sipas të dhënave të gjeneruara nga Agjencia e Statistikave, mjaft e ulët në vetëm rreth 16.33% të totalit të burimeve primare të disponueshme të energjisë. Lëndët djegëse fosile përbëjnë 83,67%, ndërsa 16,33% janë burime të ripërtëritshme prej të cilave të kategorizuara: biomasa: 12,91%, hidroenergji: 0,92%, era: 0,25%, energjia diellore: 0,14% dhe energjia elektrike: 2,10% të totalit. Për të arritur objektivat e dakorduara të dekarbonizimit, të premtuara në Deklaratën e Sofjes, është veçanërisht e rëndësishme, rritja e raportit të burimeve të

<sup>1</sup> Komisioni i BE-së, Raporti i Progresit për Kosovën 2023. [↗](#)

<sup>2</sup> KEDS Energy, Konsumatorët ekzistues [↗](#)

<sup>3</sup> Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë, Sektori Rezidencial [↗](#)

ripërtëritshme të energjisë. Rivendosja e bllok tarifave në sektorin e energjisë elektrike, në sektorin e amvisërisë, është bërë një mekanizëm i suksesshëm për uljen e kërkesës për energji elektrike.

Përfitimet që rrjedhin nga zbatimi i efijencës së energjisë janë jashtëzakonisht të rëndësishme, për t'i maksimizuar këto, duhet të ketë më shumë konsultime dhe angazhime të të gjithë akterëve të rëndësishëm, jo vetëm atyre që lidhen drejtpërdrejt me sektorin. Angazhimi dhe komunikimi i palëve të interesit si një proces kyç duhet të zhvillohet me përfshirjen edhe të atyre që kanë interes dhe fuqi inovative dhe kanë impakt të madh në dialogun dhe mobilizimin social. Prandaj, përfshirja e sektorit joqeveritar si organizatat e shoqërisë civile, akademja, shoqatat e ndryshme dhe sektori privat janë të rëndësishëm për t'u përfshirë në dialogun social, si pararendës për arritjen e rezultateve të përbashkëta qoftë në aspektin legjislativ, përcaktimin e politikave, apo ideimin e projekteve konkrete. Kjo ka rëndësi të veçantë, pasi konsultimi me palët e interesit paraqet "hulumtimin më të mirë të tregut". Kjo pastaj mundëson arritjen e një produkti që derivon nga kërkesa, që pastaj nënkupton që edhe ka përdorim të gjerë të përgjithshëm dhe siguron që ai nuk do të dështojë, por do të japë rezultatet të qëndrueshme, pasi që palët e interesit janë akterët që kanë njohuri se cilat mund të jenë nevojat në anën tjetër të spektrit.

Adresimi i sfidave të efijencës së energjisë në Kosovë kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, duke përfshirë: reformimin e politikave, përmirësimin e infrastrukturës, angazhimin publik dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Duke i dhënë përparësi praktikave të qëndrueshme dhe duke përqaftuar teknologjitë më të gjelbërta, Kosova mund të bëjë hapa të rëndësishëm drejt një sektori energjetik më eficient dhe më miqësor ndaj mjedisit. Efijenca e energjisë në Kosovë për fat të keq nuk është parë si një aspekt i rëndësishëm dhe as si prioritet. Sektori rezidencial në Kosovë konsumon afërsisht 40% të energjisë, dhe kur krahasohet me mesataren e BE-së, kërkesa për energji për metër katror është dy herë më e lartë. Rritja e efijencës së energjisë (EE) është thelbësore për zhvillimin ekonomik, pasi kursimet nga EE tejkalojnë shumicën e kostove të gjenerimit. Kosova, si anëtare e Komunitetit të Energjisë së BE-së, është e përkushtuar në zbatimin e kapitullit të energjisë të Acquis të BE-së. Prandaj, qeveria synon të arrijë një reduktim prej 32.5% të konsumit të energjisë deri në vitin 2030, në përputhje me objektivat e BE-së për efijencën e energjisë.<sup>4</sup>

Kosova është e përkushtuar për të marrë pjesë aktive në përpjekjet mbarëbotërore për të luftuar ndryshimet klimatike, kjo më së miri e ilustruar me miratimin e Deklaratës së Sofjes. Edhe pse jo formalisht anëtare e Marrëveshjes së Parisit, Kosova ka zgjedhur të përafrohet vullnetarisht me qëllimin kryesor për të kufizuar ngrohjen globale nën 1.5 gradë Celsius. Pasi që Kosova nuk është nënshkruese e UNFCCC-së apo Marrëveshjes së Parisit, ajo nuk është e obliguar të dorëzojë Kontributet e Përcaktuara Kombëtare (KPK). KPK vullnetare synon të reduktojë emetimet e gazrave serrë në 8.95 Mt CO<sub>2</sub>e deri në vitin 2030<sup>5</sup>, që përfaqëson një reduktim prej 10.25% nga nivelet e vitit 2020 prej 10.2 milion ton CO<sub>2</sub> ekuivalent (AKMM<sup>6</sup>). Përveç kësaj, Kosova planifikon të rrisë pjesëmarrjen e energjisë së ripërtëritshme në totalin e saj të energjisë nga 16.3% (të dhënat e ASK-së) në 32% deri në vitin 2030.

Përmirësimi i efijencës së energjisë në Kosovë jo vetëm që forcon sigurinë energjetike duke ulur nevojën për import sezonal të energjisë, por gjithashtu nxitë krijimin e vendeve të reja të punës. Për më tepër, kontribon në uljen e ndotjes vendore dhe globale dhe ndihmon në përmbushjen e detyrimeve të përshkruara në Traktatin e Komunitetit të Energjisë të BE-së.<sup>7</sup>

<sup>4</sup> Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit, Making Kosovo Energy Efficient, Making Kosovo Energy Efficient - giz.de [↗](#)

<sup>5</sup> UNDP, Kosovë, Premtimi për Klimën. [↗](#)

<sup>6</sup> AKMM, Raport Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2021, Gusht 2022, Prishtinë. [↗](#)

<sup>7</sup> Banka Botërore, Efijencia e Energjisë në Kosovë. [↗](#)



Vetëdijësimi i publikut është një aspekt tjetër i rëndësishëm që duhet të zhvillohet më tej, këtu roli i akademisë, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të ndryshme publike është kritik për të rritur vetëdijësimin e përgjithshëm të qytetarëve, duke mbrojtur kështu mjedisin dhe ekonominë. Kjo duhet të kanalizohet përmes përdorimit të mediave, por edhe duke përdorur mediat sociale. Është e rëndësishme të edukohen qytetarët dhe bizneset për përfitimet e masave dhe investimeve në eficiencën e energjisë, duke nxitur kështu një kulturë që është në ekuilibër me mjedisin dhe është përgjegjëse në konsumin e energjisë dhe e shfrytëzon energjinë si një burim të rëndësishëm dhe të vlefshëm.

## Metodologjia e përdorur në raport

Gjatë hartimit të këtij raporti, ishte thelbësore të sintetizoheshin njohuritë e mbledhura nga burime të ndryshme, duke përfshirë hulumtimin, konsultimet me palët e interesit dhe analizën e të dhënave. Hulumtimi përfshinë rishikimin e literaturës ekzistuese, janë shfrytëzuar raporte të ndryshme, si Raporti Vjetor i Energjisë 2022 nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Raporti Vjetor i Implementimit të Komunitetit të Energjisë – Kosovë, Bilanci Vjetor i Energjisë së Republikës së Kosovës nga ASK-ja, Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosova 2022 – 2031 dhe studime dhe publikime të tjera relevante për gjendjen e energjisë në vend dhe eficiencën e energjisë, duke ofruar një bazë të njohurive dhe kontekst për raportin. Konsultimet me palët e interesit përfshijnë diskutimet me zyrtarë dhe organizata relevante, siç janë institucionet qeveritare si MMPHI dhe Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, dy zyrtarë. Agjencitë e pavarura si Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – një zyrtar dhe një zyrtar nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Një ekspert dhe udhëheqës i komunitetit, nga industria - Shoqata e Energjisë së Ripërtërishme dhe përfaqësues i kompanisë aktive veçanërisht në fushën e erës dhe diellit, dhe dy zyrtarë nga organizata joqeveritare relevante të sektorit. Këto konsulta shërbyen për të mbledhur perspektiva, përvoja dhe njohuri të ndryshme, ndihmuan që raporti të pasqyronte pikëpamjet, shqetësimet dhe rekomandimet e palëve kryesore të interesit dhe të nxisë zotërimin e përbashkët të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Analiza e të dhënave përfshin mbledhjen dhe analizimin e të dhënave relevante siç janë ato të ofruara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Zyra e Rregullatorit për Energji, të dhëna të rëndësishme siç janë modelimet e konsumit të energjisë për vite, trendet teknologjike, dinamikat e tregut dhe kornizat e politikave. Duke aplikuar metoda analitike sasiore dhe cilësore, mund të identifikohen trendet, modelet, tendencat dhe korrelacionet, duke ofruar njohuri të mbështetura në të dhëna si dëshmi për situatën aktuale dhe mundësitë potenciale për përmirësim në të ardhmen, të cilat janë paraqitur në këtë raport. Sintetizimi i njohurive mundëson identifikimin e temave, modeleve dhe rekomandimeve gjithëpërfshirëse që mund të informojnë në zhvillimin e politikave, planifikimin strategjik, vendimmarrjen dhe veprimin për të nxitur ndryshime pozitive në këtë sektor.

## 2. Korniza politike, ligjore dhe strategjike

Fillimi i krizës energjetike, pas fazës së hapjes pas pandemisë COVID-19 dhe luftës në Ukrainë, rezultoi në ngritje të çmimeve të energjisë, dhe si rrjedhojë siguria e furnizimit dhe për rrjedhojë zëvendësimi i importit të energjisë, u bë një element vendimtar për të përballuar energjinë me çmime shumë të larta në tregjet e hapura. Kosova, në këtë situatë ka reaguar duke filluar një sërë masash të rëndësishme të politikave që synonin zvogëlimin e kërkesës, në mënyrë që të mundësojë furnizimin e rregullt me energji dhe sidomos me energji elektrike në tregun e brendshëm. Kjo rritje e përgjithshme e çmimit nuk reflektoi vetëm kostot e energjisë elektrike, por edhe të produkteve të naftës dhe biomasës. Shteti u detyrua të ndërhynte shumë herë në treg për të mbrojtur konsumatorët nga çmimet e larta dhe nga spekulimet e çmimeve.

Kjo situatë e re nxiti një rritje të masave të ndërmarra nga qeveria për të përmirësuar eficiencën e përgjithshme të energjisë në mënyrë që të ulë importet e shtrenjta të energjisë.

Ndërlidhur me këtë, është hartuar edhe një plan për të nxitur Ndërtesat me Energji gati Zero dhe gjithashtu një Strategji për Rinovimin e Ndërtesave<sup>8</sup>, statusi i këtij plani kombëtar është ende në fazën e hartimit. Ligji i ri për Performancën Energjetike në Ndërtesa (i cika ka hyrë në fuqi në fund të muajit qershor 2024) në nenin 7 mandaton MMPHI-në, me mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë, që brenda 12 muajve pas hyrjes në fuqi të ligjit të zhvillojë një strategji afatgjatë për rinovimin e ndërtesave (SRN). Qëllimi i strategjisë është të mobilizojë investimin në rinovimin e stokut të ndërtesave kombëtare<sup>9</sup>.

Në vitin 2019 u krijua Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, me rreth 20 milionë euro financim, të siguruar. FKEE ka financuar gjerësisht masa për eficiencën e energjisë në ndërtesat publike në të gjithë vendin<sup>10</sup>. Nëpërmjet financimit të masave të eficiencës së energjisë dhe ofrimit të ekspertizës, është bërë i mundur krijimi i komoditetit në ndërtesat komunale, sallat sportive dhe qendrat mjekësore familjare aty ku këto masa janë zbatuar.<sup>11</sup> Përveç rritjes së komoditetit, ndërtesat publike të rinovuara, kanë ulur kërkesën dhe faturat e tyre të energjisë dhe kanë kontribuar në një mjedis më të mirë dhe kanë rritur vlerën arkitekturore të ndërtesës. FKEE filloi punën në vitin 2023 për të përfshirë edhe sektorin privat dhe atë rezidencial, duke replikuar përfitimet e eficiencës së energjisë edhe në këtë sektor.

Në përgjithësi, Kosova ka një kornizë strategjike dhe ligjore të përcaktuar mirë, që mbulon aspektet ligjore dhe strategjike relevante për rregullimin dhe funksionimin e fushës së energjisë, e cila gjithashtu mbulon sektorin e eficiencës së energjisë.



<sup>8</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Raporti i Zbatimit 2021, Nëntor 2021

<sup>9</sup> [LIGJI NR. 05/L-101 PER PERFORMANCEN ENERGETIKE NE NDERTESA](#)

<sup>10</sup> IBID

<sup>11</sup> [Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, Financimi i Projekteve Komunale.](#)

## 2.1 Strategjia e Energjisë

Pasqyron përkushtimin e fortë për të përmirësuar eficiencën e energjisë në Kosovë në përgjithësi, megjithatë ka një sërë sfidash me të cilat po përballlet ky sektor në Kosovë. Dokumenti më i rëndësishëm që buron nga korniza ligjore, i cili përcakton edhe vizionin, orientimin, objektivat dhe vizionin e sektorit të eficiencës së energjisë pa dyshim është "Strategjia e Energjisë 2022 – 2031". Një nga pesë shtyllat kryesore të Strategjisë është edhe eficientia e energjisë. Qëllimi kryesor i rritjes së eficiencës së energjisë, ndahet në dy objektiva kryesore duke u fokusuar në përmirësimin e eficiencës energjetike të ndërtesave dhe promovimin e kogjenerimit eficient dhe të sistemeve eficiente të ngrohjes qendrore. Strategjia parasheh një lëvizje të madhe të sektorit energjetik të Kosovës, nga shumë i varur nga përdorimi i teknologjive konvencionale për prodhimin dhe konsumin e energjisë, në një sektor shumë më të larmishëm dhe më të avancuar. Kjo parashikohet të arrihet me një sërë masash, si p.sh. integrimi i një sasive të konsiderueshme të burimeve të ripërtëritshme si era dhe dielli - parashihen 1400 MW kapacitet të instaluar, nga të cilat 700 MW kapacitet të instaluar diellor. Heqja graduale e qymyrit deri në vitin 2050, sigurimi i një tranzicioni të drejtë energjetik, eficientia e energjisë, rritja e aftësive të sigurisë kibernetike, integrimi i teknologjive të reja dhe inovacioni në këtë sektor janë prioritetet në Strategji.<sup>12</sup> Deri në përfundimin e vitit 2022, Kosova kishte regjistruar 276.2 MW të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të ripërtëritshme, që përfshinë 128 MW nga hidrocentralet e vogla, 137 MW nga era, 10 MW nga dielli dhe 1.2 MW nga biomasa. Për t'u përfruar me objektivat e përcaktuara në Strategjinë e Energjisë dhe Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, Kosova duhet të tërheqë investime të reja në burimet e ripërtëritshme të energjisë. Përveç kësaj, Kosova duhet të intensifikojë përpjekjet e saj për të avancuar më tej kornizën ligjore që ka të bëjë me burimet e ripërtëritshme.<sup>13</sup>

Nga analiza e Strategjisë vërehet se sfidat kryesore që po i kalon sektori janë: vendi ende përballlet me një intensitet shumë të lartë energjetik, duke u shprehur se vendi ka intensitetin më të lartë të energjisë në rajon. Intensiteti i energjisë përcaktohet nga sasia e energjisë së nevojshme për njësi të prodhimit ose aktivitetit, që do të thotë se reduktimi i përdorimit të energjisë në prodhimin e produktit ul intensitetin.<sup>14</sup>

Korniza ligjore dhe rregullatore duhet të përditësohet në një mënyrë të atillë që të inkurajojë fuqizimin e sektorit privat në sektorin e eficiencës së energjisë, duke inkurajuar kompanitë ESCO, e njëkohësisht më shumë nisma private për të përmirësuar eficiencën e energjisë, veçanërisht në stokun e përgjithshëm të ndërtesave në vend. Një sfidë tjetër e madhe është kapaciteti i ulët i ekspertizës në fushën e eficiencës së energjisë, përkatësisht auditorëve të energjisë, jo vetëm në sektorin privat, por edhe në institucionet publike. Nuk ka mjaft zyrtarë publikë që punojnë në fushën e eficiencës së energjisë, duhet të ketë më shumë programe dhe iniciativa për masat e eficiencës së energjisë në sektorin privat-rezidencial. Për të rritur eficiencën e energjisë në përputhje me Strategjinë e Energjisë, Kosova duhet të sigurojë fonde shtesë dhe të forcojë kapacitetet institucionale për zbatimin dhe mbikëqyrjen e masave të kursimit.<sup>15</sup> Përpjekjet për të rritur eficiencën e energjisë në sektorët industrialë dhe të transportit janë trajtuar në dokumente të veçanta strategjike që po zhvillohen aktualisht dhe janë në fazën e draftit.

Zhvillimi i vazhdueshëm i kornizës ligjore, duke përfshirë përfundimin e rishikimeve të ligjeve për eficiencën e energjisë dhe performancën energjetike të ndërtesave. Përmirësimi i kornizës rregullatore, si Kodi i Ndërtimit dhe

<sup>12</sup> Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031, Qeveria – Ministria e Ekonomisë.

<sup>13</sup> Komisioni i Bashkimit Evropian, RAPORTI I PROGRESIT TË KOSOVËS 2023.

<sup>14</sup> Departamenti Amerikan i Energjisë, Zyra e Eficiencës së Energjisë dhe Energjisë së Ripërtëritshme. [Eficientia e Energjisë kundrejt Intensitetit të Energjisë - Analizë Strategjike](#).

<sup>15</sup> Komisioni i Bashkimit Evropian, RAPORTI I PROGRESIT TË KOSOVËS 2023.

rregulloret për etiketimin dhe eko-dizajnin, do të krijojnë një bazë të fortë për arritjen e objektivave të efijencës së energjisë.

Për më tepër, Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë duhet të jetë më aktiv në sektorin privat, jo vetëm në sferën e sektorit publik.

## 2.2 Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë 2025-2030

Ende nuk është përfunduar, ai është një instrument që përmban masa, synime dhe strategji se si të arrihet një e ardhme me karbon të ulët. Plani prezantohet për vlerësim të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, si një zotim i vendit se si të arrihen reformat dhe cilat janë masat e parashikuara në fushën e sektorit të energjisë. Plani parashikohet të finalizohet dhe të dorëzohet në qershor 2024.

Më 10 korrik 2023, Kosova i dorëzoi Sekretariatit Planin e saj Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) për shqyrtim, sipas Rregullores për Qeverisjen e Komunitetit të Energjisë. Sekretariati vlerësoi draftin, duke konfirmuar përputhshmërinë e tij me kërkesat rregullatore dhe masat gjithëpërfshirëse. Objektivat e përshkruara në PKEK përputhen me objektivat 2030 të vendosura nga Këshilli i Ministrorëve të Komunitetit të Energjisë në 2022, nga të cilat përmirësimi i efijencës së energjisë, përdorimi i burimeve të ripërtëritshme, reduktimi i emetimeve të gazrave serrë, optimizimi i tregjeve të brendshme të energjisë dhe avancimi i kërkimit dhe inovacionit janë aspekte kyçe.<sup>16</sup>

Plani thekson parimin “efijencia e energjisë në rend të parë”, i inkorporuar në PKEK brenda dimensionit të tij të efijencës së energjisë dhe thekson prioritetin e masave kost-efektive të efijencës së energjisë gjatë formimit të politikës së energjisë dhe vendosjes për investime. Shumica e masave në këtë aspekt përqendrohen në rritjen e efijencës së energjisë përmes rinovimeve të ndërtesave.

Pas rishikimit të PKEK-së, duhet të përcaktohen data të qarta dhe reale për mbylljen e Kosovës A dhe Kosovës B, ose të paktën opsionet për datat e mbylljes. Pas rinovimit të termocentralit Kosova B, dy njësitë Kosova A do të mbahen në rezervë strategjike, ndërsa një njësi mund të mbyllet, kur të arrihet energjia e ripërtëritshme në dispozicion në masën e duhur. Një prezantim gradual i çmimit të karbonit duhet të vendoset sa më shpejt që të jetë e mundur, duke filluar me një tarifë më të ulët dhe duke e rritur gradualisht atë. Çmimi i karbonit duhet të arrijë nivelin e Skemës së Tregtimit të Emetimeve të BE-së më së voni deri në vitin 2030, në mënyrë që të shmangët Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit. Taksa/çmimi i karbonit duhet të përdoret si përpjekje për dekarbonizim dhe jo të shkojë në buxhetin e shtetit në përgjithësi. Duhet të vazhdohet me miratimin e Strategjisë së Rinovimit të Ndërtesave, edhe para miratimit të PKEK.

Në PKEK duhet të identifikohen barrierat aktuale për përdorimin e pompave termike në amvisëri dhe biznese të vogla dhe të përshkruhen masat për tejkalimin e tyre, duke përfshirë nxitjet tatimore, pasi në plan parashikohen vetëm subvencione deri në 2,500 euro si masa potenciale. Në plan, pompat termike për ndërtesat e banimit duhet të promovohen pasi ato përdorin katër deri në pesë herë më pak energji se sistemet e tjera të ngrohjes, si dhe të nxitet ngrohja diellore e ujit, e cila mund të zvogëlojë nevojën për energji elektrike ose ngrohje me dru dhe është shumë kost-efektive.<sup>17</sup> Në Plan pompat termike dhe stufat më efijente të biomasës shihen si një formë për të mbrojtur natyrën dhe për të ulur kërkesën për dru zjarri, por edhe një formë për të arritur një efijencë të përgjithshme më të lartë dhe një sasi më të lartë të energjisë së ripërtëritshme në miksin total të energjisë.

<sup>16</sup> Komuniteti i Energjisë, 2023. [↗](#)

<sup>17</sup> BERZH – Me pompat termike mundësohet një mjedis jetese i rehatshëm ndërsa shpenzojnë 4 deri në 5 herë më pak energji. Qasja: (Anglisht) Pompat e nxehtësisë – Shijoni një ambient të rehatshëm jetese duke shpenzuar 4 deri në 5 herë më pak energji – GEFF Kosova (ebrdgeff.com)



## 2.3 Korniza Ligjore në Kosovë

10

Në përgjithësi është në nivel të mirë, ndryshimet e vogla në këtë kornizë duhet të përshtaten në mënyrë që të përmirësohet më tej infrastruktura ligjore për eficiencën e energjisë dhe zhvillimin e BRE-ve që sektori sidomos ai privat/rezidencial të avancojë edhe më tutje.

Konsumatorët dhe grupet e cënueshme, duhet të mbrohen më tej me ligj dhe duhet mbështetur vlerësuesit e energjisë në aplikimin e Certifikatave të Performancës Energjetike për ndërtesat, në aplikimin e tyre në Kosovë. Gjithashtu, auditorët e energjisë duhet të rregullohen më mirë me ligj. Është e domosdoshme që Kosova të prezantojë menjëherë certifikimin e performancës energjetike për ndërtesat dhe të miratojë Strategjinë e Rinovimit të Ndërtesave dhe Planin për Ndërtesat me Energji pothuajse Zero.<sup>18</sup> Ja vlen të përmendet se këto dy dokumente do të hartohen konform obligimeve të Ligji NR. 08/L-242 për Performancën Energjetike të Ndërtesave. Nga komunikimi me zyrtarë të Ministrisë së Ekonomisë u kuptua se MMPHI është në proces dhe në bashkëpunim me ME dhe donatorët janë në fazën e finalizimit të softuerit për llogaritje të Certifikatës së Performancës energjetike në ndërtesa, ku më 14 shkurt të 2023 kanë certifikuar 15 Trajner të këtij softueri nga Instituti Franhofer dhe i përkrahur nga KfW. Gjithashtu është në fazën e finalizimit të Regjistrimit Kombëtar, ku e cila platformë do të përcjellë gjithë procedurën e Certifikimit energjetik të ndërtesave, duke filluar nga faza trajnuese e Vlerësuesëve të energjisë, faza e aplikimit si dhe deri te pajisja me Certifikatë të Performancës energjetike në Ndërtesa.

Ligji për Eficiencën e Energjisë Nr. 06/L-079, i cili përfshinë dispozitat e Direktivës 2012/27/BE, u miratua më 7 nëntor 2018. Ky ligj kryesisht rrjedhë dhe ndërlihet me disa nga ligjet relevante të energjisë, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me ligjin për energjinë, energjinë elektrike, rregullimin e energjisë, ndërtimin dhe performancën energjetike të ndërtesave.

Ligji për Eficiencën e Energjisë i vitit 2018 prezantoi detyrimet dhe objektivat për eficiencën e energjisë. Megjithatë, ndryshimet në këtë ligj janë duke u bërë për të përafruar me objektivat e reja të eficiencës së energjisë, të vendosura nga Direktiva e rishikuar për Eficiencën e Energjisë (DEE). Kosova ka miratuar rregulloret e nevojshme për të miratuar Ligjin për Performancën Energjetike të Ndërtesave.<sup>19</sup> Ky ligj - Nr. 08/L-242 është miratuar me 12 Qershor 2024, dhe në të parashikohet edhe sistemi i certifikatave të energjisë që do të jenë të detyrueshme për të gjitha ndërtesat, dhe shitja apo lëshimi me qira i objekteve të ndryshme do të kushtëzohet edhe me paisjen me këtë certifikatë.<sup>20</sup>

Udhëzimi Administrativ – MMPHI, nr. 15/23, me plotësim ndryshimin e UA – MMPHI, nr. 13/08 siç përcaktohet nga legjislacioni përkatës për energjinë, vendosja e paneleve solare-fotovoltaike në çati, për prodhimin e energjisë elektrike për qëllime vetëkonsumi u mundësua për konsumatorët familjarë me fuqi të instaluar deri në 7 kW; Për më tepër ky plotësim-ndryshim mundëson vendosjen e termoizolimit në muret e jashtme të shtëpive ekzistuese familjare, por që nuk ndryshojnë funksionalitetin dhe nuk bien ndesh me nenin 14 nënparagrafi 1.5 i Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim.<sup>21</sup> Ky ndryshim ishte i një rëndësie të madhe për të mundësuar funksionimin e instalimeve solare në vend pasi një pengesë e rëndësishme burokratike u lehtësua, përkatësisht ajo e të paturit të një leje të veçantë për instalimin e paneleve diellore, me kusht që shtëpia të ishte zyrtarisht e legalizuar, kur dihet që shumica e ndërtesave në vend nuk janë legalizuar ende.

<sup>18</sup> Komisioni i BE-së, Raporti i Progresit të Kosovës 2023. [↗](#)

<sup>19</sup> Komuniteti i Energjisë, Raporti i Implementimit 2023 – Kosovë\*, 1 nëntor 2023.

<sup>20</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [↗](#)

<sup>21</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [↗](#)

### 3. Analiza e gjendjes - eficienca e energjisë në Kosovë

11

Energjia në Kosovë rrjedhë nga tre burime kryesore, thëngjilli i linjtit, i cili është shumë i bollshëm në Kosovë, por edhe jashtëzakonisht ndotës për mjedisin dhe kontribuon në ndryshimet klimatike, si dhe nafta dhe biomasa për ngrohje dhe amvisëri. Ky model i konsumit të energjisë nuk është i qëndrueshëm pasi bazohet shumë në përdorimin e lëndëve djegëse fosile. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2021, burimet kryesore të energjisë të shfrytëzuara në Kosovë përfshinin thëngjillin 1,564 ktoe, produktet e naftës (si benzina, nafta, vajguri dhe gazi i lëngshëm i naftës - LPG) në 789 ktoe, biomasa 363 ktoe, hidroenergji 26 ktoe, era 7 ktoe, energjia diellore 4 ktoe, dhe energjia elektrike 59 ktoe. Sasia totale e energjisë në dispozicion për konsum në vitin 2021 u regjistrua në 2,813.51 kiloton ekuivalent naftë (ktoe), duke shënuar një rritje prej 2.91% krahasuar me vitin 2020.<sup>22</sup>

Kosova ka një intensitet shumë të lartë energjetik që duhet të ulet, gjë që është shenjë se ekonomia nuk është në eficiencën e saj optimale dhe se vendi në përgjithësi ka një potencial të gjerë dhe të pashfrytëzuar si në përfitimet e eficiencës së energjisë ashtu edhe në shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, veçanërisht erën dhe diellin. Kjo është e një rëndësie të madhe për të mundësuar sigurinë e furnizimit me energji, por ofronë gjithashtu shfrytëzim eficient të burimeve dhe rezultate më të mira ekonomike, shëndetësore dhe mjedisore.<sup>23</sup>

Konsumi i energjisë për kokë banori shërben si masë e matjes së zhvillimit ekonomik dhe eficiencës së një vendi. Në Kosovë, energjia e konsumuar për person në vitin 2015 ishte afërsisht 1.02 ton ekuivalent naftë (toe) për kokë banori. Gjithashtu, intensiteti i energjisë për të njëjtin vit u regjistrua në 0.31 toe për 1000€, që paraqet efikasitet relativisht të ulët energjetik të ekonomisë së vendit. Një vlerë më e ulët tregon një ekonomi më efikase për sa i përket konsumit të energjisë dhe produktivitetit.<sup>24</sup> Ndërsa intensiteti i energjisë ra në 0.226 toe për 1000€ të prodhimit ekonomik të arritur në 2021, ose 0.618 ton ekuivalent naftë (toe) për kokë banori.<sup>25</sup>

Ndërsa pjesa më e madhe e energjisë në Kosovë, siç është nafta e përdorur në vend, përdoret nga transporti (422 ktoe, ose 99% e totalit të energjisë së këtij sektori), industria (191.86 ktoe, ose 61%), shërbimet (43.72 ktoe, ose 26%), sektori i bujqësisë (21.68 ktoe – 56%). Në anën tjetër thëngjilli në Kosovë (1564 ktoe) kryesisht shëndrrohet në energji elektrike dhe një pjesë e kësaj energjie përdoret si ngrohje qendrore në kryeqytet.

Sa i përket energjisë elektrike, prodhimi vjetor i Kosovës kryesisht rrjedh nga linjiti, në vitin 2022 janë nxjerrë dhe konsumuar 8.28 milionë tonë linjit dhe është gjeneruar 6,346 MWh energji elektrike nga të cilat 668 MWh janë përdorur nga vetë termocentralet. Ndërsa kërkesa totale në vitin 2022 ishte 6,547 GWh. Në vitin 2022, prodhimi i energjisë së ripërtëritshme të integruar në rrjetin e transmetimit arriti në 469.4 gigavat-orë (GWh), duke shënuar një rritje të dukshme prej 57.8% krahasuar me një vit më parë. Importi për vitin 2022 ishte 761 GWh, ndërsa eksportet arritën në 787 GWh. Ndërkohë që humbjet në shpërndarje janë ende shumë të larta në 1,403 GWh ose arrijnë në 22.63%, nga të cilat 5.85% (362 GWh) janë shpenzuar nga 4 komunat veriore serbe, por nuk janë paguar.<sup>26</sup>



<sup>22</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, BILANCI VJETOR I ENERGJISE 2021.

<sup>23</sup> Banka Botërore, Eficienca e Energjisë në Kosovë, 1 maj 2019. Marrë nga: Efikasiteti i Energjisë në Kosovë (worldbank.org)

<sup>24</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, BILANCI VJETOR I ENERGJISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS për vitin 2015, Prishtinë, 2016. ↗

<sup>25</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, BILANCI VJETOR I ENERGJISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS NË VITIN 2021, Prishtinë, 2022. ↗

<sup>26</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji, Raporti Vjetor 2022. Prishtinë, Mars 2023. ↗




|                   | Njesia | Prodhimi | Kerkesa | Importi | Eksporti | Humbjet    |             |
|-------------------|--------|----------|---------|---------|----------|------------|-------------|
|                   |        |          |         |         |          | Transmetim | Shperndarje |
| Realizimi 2022    | GWh    | 6,315    | 6,547   | 761     | 787      | 118        | 1,403       |
| Bilanci 2022      | GWh    | 6,598    | 7,008   | 1,573   | 1,026    | 137        | 1,440       |
| Realizim/Bilanci  | %      | 95.71    | 93.43   | 48.39   | 76.69    | 86.32      | 97.4        |
| Realizimi 2021    | GWh    | 6,207    | 6,885   | 1,311   | 835      | 120        | 1,538       |
| Raporti 2022/2021 | %      | 101.74   | 95.1    | 58.07   | 94.23    | 98.54      | 91.19       |

Siç shihet nga tabela e mësipërme, kërkesa e parashikuar është menduar të jetë më e lartë në projeksion – bilancin për vitin 2022, ajo që ka ndikuar në rënien e kërkesës është edhe pse numri i inverterëve AC për ngrohje është në rritje, është rivendosja e bllok tarifave, ku konsumatorët familjarë që kalojnë pragun prej 800 KWh (tarifa e lartë 7.79 euro cent/KWh, tarifa e ulët 3.34 KWh euro cent) të energjisë elektrike mujore do të paguajnë çmime dukshëm më të larta të energjisë elektrike (Mbi 800 KWh në muaj, një strukturë tjetër çmimesh aplikohet, tarifa e lartë: 14.45 euro cent/KWh, tarifa e ulët, 6.81 euro cent për KWh)<sup>27</sup>. Kjo dekurajoi përdorimin e pajisjeve joeficiente për qëllime të ngrohjes, inkurajoi njerëzit të zgjedhin dhe të zbatojnë masat e efijencës të energjisë.

Humbjet e larta të energjisë veçanërisht në sistemin e shpërndarjes duhet të ulen, ato ishin 38% në vitin 2010, ndërsa sipas Zyres së Rregullatorit për Energji kanë rënë në 22% në 2023. Megjithatë përdorimi i paautorizuar dhe humbjet e energjisë elektrike/komerciale mbesin shqetësuese dhe më tepër veprim kërkohet në adresimin e kësaj problematike. Kalibrimi i njehsorëve dixhitalë të energjisë duhet të përmirësohet, veçanërisht në përcaktimin e tarifave të larta dhe të ulëta. Këto kanë një ndikim negativ në sistemin e përgjithshëm dhe rrisin çmimet për klientët e rregullt.

► **FIG 1.** Struktura e energjisë elektrike të konsumuar sipas sektorëve (ASK, 2023 28)



<sup>27</sup> KEDS/KESCO, strukturë tarifore për konsumatorët rezidencialë. Qasja: eKesco - KESCO ([kesco-energy.com](https://kesco-energy.com))

<sup>28</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Statistikat e Energjisë, Prishtinë, maj 2023. Marrë nga: ([rks-gov.net](https://rks-gov.net))

Siç shihet nga përshkrimi i mësipërm, përdoruesi më i madh i energjisë elektrike në Kosovë është sektori i amvisërisë me 60% të totalit të energjisë elektrike të konsumuar për vitin 2022, i ndjekur nga sektori komercial me 24%. Janë pikërisht këta dy sektorë ku duhet të bëhet përqendrimi kryesor i masave të efijencës së energjisë pasi këtu qëndron pjesa më e madhe e fitimeve të shpejta në arritjen e kursimeve maksimale. Ndërsa në dy sektorët e tjerë të ndërlidhur - industria dhe minierat fitimet janë më të vogla pasi këta sektorë prirën të jenë më pak reaktiv dhe me më pak mundësi kursimi të energjisë dhe hapësirë të kufizuar për zbatim të masave të EE.

Përfitime tjera nga zbatimi i reformave të tilla të rëndësishme sistematike padyshim janë edhe ofrimi i mundësive për të diversifikuar sistemin energjetik, për të kontribuar në punësimin lokal dhe gjithashtu për të ofruar një kontribut për të zbutur ndryshimet klimatike globale dhe për të arritur qëllimet e përgjithshme të qëndrueshmërisë.

Investimet në efijencën e energjisë brenda sektorit publik kanë potencial për të reduktuar ndjeshëm shpenzimet në konsum të energjisë, duke liruar kështu burime financiare për nevoja të tjera zhvillimore. Njëkohësisht, kjo rrit konkurrencën dhe nxit krijimin e vendeve të punës. Shembujt globalë tregojnë se investime të tilla në efijencën e energjisë në sektorin publik mund të veprojnë si katalizatorë për tregjet e efijencës së energjisë, duke u mundësuar qeverive të krijojnë precedentë, duke udhëhequr rrugën për përmirësime të krahasueshme edhe në sektorin privat.<sup>29</sup>

Sfidat ku kemi ngecur lidhen me shumë faktorë, ndër më të rëndësishmit mund të konsiderohen: mungesa e fondeve, prioritetet buxhetore të Kosovës duke kaluar në sektorë të tjerë, veçanërisht në atë të mbrojtjes, duke e lënë sektorin e efijencës së energjisë më shumë në mëshirën e donatorëve të huaj, të tillë sikurse është BE-ja. Kosova ende duhet të finalizojë miratimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për rinovimin afatgjatë të ndërtesave ku mund të arrihet qëllimi kryesor në efijencën e energjisë dhe ku qëndron potenciali kryesor i kursimeve dhe uljes së konsumit.

Sfidë mbetet kapaciteti i ulët në terren, numri i ulët i auditorëve të energjisë, mungesa e mjeteve financiare nga popullata e përgjithshme për të investuar në masat e efijencës së energjisë, mungesa e njohurive teknike, ndër të tjera edhe vetëdijësimi i ulët. Për më tepër, hartimi i planeve infrastrukturore dhe strategjike duhet të pasohet nga implementimi, pasi këto kanë tendencë që të mbesin prapa.

<sup>29</sup> Banka Botërore, Efijencia e Energjisë në Kosovë. [↗](#)



## 4. Masat, politikat dhe veprimet e qeverisë

Kriza e fundit energjetike në Evropë ka nënvizuar rëndësinë e zbatimit të një programi mbrojtës gjithëpërfshirës për konsumatorët e cenueshëm. Programi aktual për të ndihmuar konsumatorët e cenueshëm në Kosovë shtrihet në ndihmën e drejtpërdrejtë financiare, në formën e subvencionimit të faturave të energjisë elektrike, vetëm për dy grupe relativisht të kufizuara: përfituesit e Skemës së Ndihmës Sociale dhe përfituesit e beneficioneve të ndërlidhura me luftën, të dy të njohur si konsumatorë të cenueshëm të energjisë elektrike. Megjithatë, duke përdorur kritere të ngushta për përzgjedhjen e përfituesve, një numër i konsiderueshëm individësh përballen me rrezikun e varfërisë energjetike dhe mbeten pa mbështetje.


Qeveria e Republikës së Kosovës vendosi të zbatojë masa emergjente në përgjigje të situatës akute globale të energjisë. Ky vendim ka ardhur në mes të një rritje të mprehtë të çmimit të importeve të energjisë dhe paralajmërimeve për ndalime të mundshme të eksporteve të karburanteve fosile nga disa vende evropiane si Hungaria, të cilat mund të përkeqësojnë më tej kostot e larta të importit. Me qëllim të sigurimit të furnizimit adekuat me energji gjatë dimrit dhe mbrojtjes së interesave publike, masat emergjente përfshinin:

- › Sigurimi i masave mbështetëse direkte për të ndihmuar qytetarët në plotësimin e nevojave të tyre për ngrohje gjatë dimrit.
- › Vendosja e ndalimit të përdorimit të energjisë elektrike për minimin e kriptomonedhave.
- › Ofrimi i mbështetjes për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për ruajtjen e sigurisë së sistemit të energjisë elektrike.
- › Zbatimi i masave për uljen e konsumit të energjisë elektrike në të gjitha institucionet.<sup>30</sup>

Në vitin 2023, Kosova ofroi subvencione për familjet për të blerë pajisje ngrohëse më efikente, si pompat termike, stufa me dru, stufa me pelet dhe stufa me briket.<sup>31</sup> Agjencia zbatuese ishte Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë - FKEE.

Republika e Kosovës miratoi Kontributin e parë të Përcaktuar Vullnetar ky gjithëpërfshirës dhe vullnetar – duke përcaktuar ambiciet e saj kryesore të politikës klimatike deri në vitin 2030. Për më tepër, Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031, së bashku me draft Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK), përshkruan politika ambicioze që synojnë lehtësimin e një tranzicioni energjetik pozitiv ndaj klimës për vendin dhe hapjen e kushteve për dekarbonizimin e plotë deri në vitin 2050.

